



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



ZYRA E KRYETARIT

01-351-29411/2025

29.08.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik, në bashkëpunim, dhe propozim të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe ZKA, merr këtë:

V E N D I M

Për

Emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës

Caktohet Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës, për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë, Jelloc, Resnikë si dhe ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukturës rrugore në gryken e Jarines-Pogragjë, me operator; Capital X Fet Sh.P.K.; N.N.Sh. World Medium; N.N.P. Atc Com Sh.P.K., Martirët Dushi 11, Klinë dhe me numër të biznesit; 811367920

Me numër të prokurimit: 634-25-6000-5-2-1 dhe me numër të kontratës 67-2025, plani për implementimin e kontratës është 10 muaj.

Vlera e kontratës është 93.980.00 Euro

I. VISAR L. BOZM Menaxher i kontratës (Udhëheqës i ekipit) caktohet:

Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

XHEBOL GASHI Menaxher i kontratës caktohet:

Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

LUAN BEKRI Menaxher i kontratës caktohet:

Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës caktohet:

II. Enver Berisha, Drejtor për Drejtorinë e Urbanizmit.

- g. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- i. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- j. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- k. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- l. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- m. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- n. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe
- o. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontratë siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.

3. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

Mbikëqyrësi drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për:

- a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
- b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ .

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës Prokurimit;
- Menaxherit të kontratës;
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës;
- Njësisë së Kërkesës;
- Arkivit të Komunës.

ZKA – KRYETARI

z. ZENUN ELEZAI





KOMUNA KLINË

Zyra e prokurimit

Nr 351-29411/25

DATE 29.08.2025

KONTRATË NR: 67-2025

Numri i kontratës:¹ 634-25-6000-5-2-1/C903

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik CAPITAL X FET/SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM; N.N.P. ATC COM SH.P.K., Martirët Dushi 11, Klinë, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë, Jelloc, Resnikë si dhe ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukturës rrugore në gryken e Jarines- Pogragjë me numër identifikues: 634-25-6000-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë, Jelloc, Resnikë si dhe ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukturës rrugore në gryken e Jarines- Pogragjë** Projekti është dy vjeçar dhe mjetet janë të ndara Ne vitin 2005 45.000.00 Euro dhe Ne vitin 2026 70.000.00 Euro

No.	Lot
1	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë, Jelloc, Resnikë si dhe ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukturës rrugore në gryken e Jarines- Pogragjë

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **93,980.00 €**; [nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.2 Plani dinamik është 10 muaj.

2.3 Sigurimi i ekzekutimit do të jete 9398.00 euro me validitet 10 muaj + 1 muaj = 11 muaj

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Ne baze të situacioneve mbi kryerje të punimeve me Raport nga Organi Mbikëqyrës dhe Fature

- Mbajtja e parasë në vlerë 9398.00 € do të paguhet pas Afatit të garancionit të punimeve mbas 12 muajve pas pranimit të përkohshëm teknik . Kjo mund të paguhet me garancion nëse ekzistojnë mjetet në dispozicion)

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

Sigurimi i ekzekutimit

Plani dinamik

Menaxheri i kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Labínot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	29.08.2015
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	BGZON BYTVET
Pozita:	
Nënshkrimi:	DEBETON
Data:	29.08.2015
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

ASFALTIMI I RRUGËVE : NË FSHATIN Jashanice Jelloc Resnik Pograxhë

1. PARAMASA PËR ASFALTIMIN E RRUGËS SIPAS SITUACIONIT TË RRUGËVE TË SPECIFIKUAR NË PROJEKT (PJESA GRAFIKE)

Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total në TVSH (€)
Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare					
1	PUNËT PARAPRAKE				
1.1	Mobilizimi i nderrmajes per aktivitet, vendosja e shenjave për sigurim te komunikacionit per aktivitet te punes ne rruge, ne bashkpunim me menaxherin e projektit. Te dhenat : L=1400.00 m' ; b=3.0 m' ; bankinat 2x0.30m , kanal për ujërat atmosferik 1m në të dy anët ku ka lëshesa. Llog m'	m	1,400.00	0.28	392.00
1.2	Shenimi i trasesë, si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit duke i trajtuar edhe elemente përcjellëse të rrugës si : Kyqja e rrugëve dytësore , interseptimi (kryqëzimi) në bazë të projektit zbatues, në matjet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike, Llog në m! Matjet gjeodezike në fund të projektit përfshihen të gjitha punët e kryera te sjellen hartat me kushtet e përgjithshme dhe teknike me gjeodet të lincenuar.	m	1,400.00	0.30	420.00
Gjithsej: Pos 1					812.00
2	PASTRIMI DHE DEMOLIMI TERENIT				
2.1	Pastrimi i terenit largimi i drunjëve, shkurret dhe rrethojave me tela xhembore dhe mbeturinat apo gjësendet tjera të ngurta që e pengojnë gjatë ekzekutimit të rrugës. Pastrimi i tyre bëhet normal me drejtimin e rrugës me gjerësi të përcaktuar me projekt sipas profilin tërthorë si dhe largimin e tyre në deponin më të afërt,. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rrethojave dhe kthimin në gjendje të mëparshme pas përfundimit të punimeve. Llog në m².	m'	1,400.00	0.30	420.00

2.2	Dislokimi i infrastrukturës nëntoksore (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit) , në trasen e rrugës ku zhvillohen punimet e rrugës , zhvendosja e tyre jashta rrugës në koordinim me institucionet përgjegjëse si KEDS , PTT , ujësjellësin rajonal. Në rast të dëmtimit eventual nga pakujdesia OE është i obliguar në afat sa më të shkurt të rikuperojë dëmet në kosto të vetë buxhetore në mënyrë që vendabnimet përreth rrugës e cila do të ndërtohet të mos mbesin pa shërbimet komunale. LLog në m' me të gjitha shpenzimet.	m'	1,400.00	0.30	420.00
2.3	Pastrimi, zhbllokimi dhe mirëmbajtja e lëshesave ekzistuese ujore në aksin e rrugës në të dy anët e rrugës.	m'	1,400.00	0.30	420.00
Gjithsej: Pos 2					1,260.00
3	PUNIMET TOKËSORE				
Gërmimi dhe Hapja e kanalit të kategorisë III-IV ,deri në thellësinë dhe me gjerësi të nevojshme për punë duke përcjellë të gjitha pikat gicodetike dhe detalet sipas projektit të dizajnuar në profilin gjatësorë dhe tërthorë . Në këtë pozicion përfshihet edhe hapja e kanaleve anësore , gërmimi dhe vendosja e lëshesave (tombinave) dhe elementët tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detalet teknike . Në çmim përfshihet edhe ngjeshja me cilindër brotkocë (papuqe vibruese) të pjesëve anësore dhe punimi i skarpatës. Dheut i tepër bartet në deponin më të afërt deri 5.0km largësi					
3.1	Punët me makineri (90%)	m3	1,500.00	1.35	2,025.00
	Punët me dorë (10%)	m3	160.00	1.00	160.00
Punimi i bazamentit (para mbushjes) me rrafshim dhe ngjeshje, si dhe rregullimi i pjerrtësisë tërthore dhe gjatësore të rrugëve sipas detalet teknike të përfshira në projekt.					
3.2	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës	m3	560.00	1.00	560.00
Mbushja , nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i me cilindër vibruës me peshë 12t deri në Ms=500kg/cm2 në të gjitha pjesët e trasës ku është bërë gërmimi.					
3.3	Plotësimi , mbushja dhe Nivelizimin e trasës së rrugës me bartje të dhut të zgjedhur deri në plotësimin e kriterëve të ngjeshjes sipas kriterëve teknike të specifikuar në përshkrimin teknik të projektit.	m3	560.00	3.00	1,680.00
Punimi i planimit dhe bankinave të rrugës dhe trotuarve me bartje të materialit shtrirje , rrafshim dhe ngjeshje me cilindër vibruës 18 tonë sipas kushteve përgjithshme dhe teknike të specifikuar në projekt.					
3.4	Punimi i planimit dhe bankinave	m3	80.00	5.00	400.00
Gjithsej: Pos 3					4,825.00
4	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)				
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavorr nga gurit të thyer fraksion 0-63 mm, me trashësi të shtresës t=20 cm të cila i plotëson kushtet e parapara për tampon si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibruës deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=600 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtojë testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentojë tek menaxheri kontratës.					
4.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm	m3	1,100.00	8.00	8,800.00

Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavorr nga gurit të thyer fraksion 0-31.5mm, me trashësi të shtresës $t=10$ cm, të cila i plotëson kushtet e parapara për tampon si dhe nivelizimi dhe ngjeshja për materialin e bankinave në të dy anet e rruges në gjerësi (2 x 0.30 cm) dhe ramje 4%, ngjeshja bëhet me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes $M_v=800$ kg/cm². Sqarim: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.

4.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm	m ³	550.00	8.00	4,400.00
-----	---	----------------	--------	------	----------

Gjithsej: Pos 4

13,200.00

5	PUNIMET E LËSHESAVE (TOMBINAVE) DHE KANALEVE TË HAPURA				
----------	---	--	--	--	--

Punimi i lëshesave, pjesëve kaluese dhe kanaleve të mbyllura në disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna në projekt. Në çmim është llogaritur hapja e kanalit dhe vendosja e rrës, furnizimi dhe vendosja e gypit armuar, duke duke përfshirë edhe kokën hyrëse dhe dalëse të lëshesës nga beton armuar sipas detalit teknik të prezentuar në projekt llog në m' me të gjitha shpenzimet

5.1	Lëshes Ø 400mm deri 10 m gjatësi	m'	20.00	5.00	100.00
-----	----------------------------------	----	-------	------	--------

5.2	Punimi i kanalit të hapur atmosferik për kullimin e ujërave atmosferik nga skarpatë dhe lëshesat me lartësi dhe gjerësi të ndryshueshme konform konfiguracionit të terenit të paraqitura në, profilet tërthore dhe gjatësore për secilen stacionazh	m'	1,400.00	0.50	700.00
-----	---	----	----------	------	--------

Gjithsej: Pos 5

800.00

6	PUNIMET E MBISTRUKTURËS ASFALTIT DHE BETONIT				
----------	---	--	--	--	--

6.1	Demolimi i kokave të pusëve ekzistuese, si dhe ngritja dhe punimi i kokave të reja, përfundimi me armaturë, si dhe inkastrimi i unazë metalike të kapakut të pusëve. Ngritja e kokës së pusëve bëhet në nivel me kuatoën e asfaltit. Në çmim llogaritet edhe vendosja e kapakut të ri prej Gize DN 600 mm. deri 40t Llog për copë me të gjitha shpenzimet.	copë	3.00	5.00	15.00
-----	--	------	------	------	-------

6.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfalt betonit nga materiali i njëtrajtshëm AB16 me trashësi $t=8,0$ cm, në çmim përfshihet edhe zgjerimi nëpër kthesa Vërejtje: Të mirren mostrat në vend dhe të bëhet ATESTI -METODA MARSHALL	m ²	4,200.00	15.67	65,814.00
-----	--	----------------	----------	-------	-----------

Gjithsej: Pos 6

65,829.00

REKAPITULIMI - ASFALTIMI E RRUGËS NË FSHATIN Jashanice Jelloc Resnik Pogradec

1	PUNËT PARAPRAKE	812.00
2	PASTRIMI DHE DEMOLIMI TERENIT	1,260.00
3	PUNIMET TOKËSORE	4,825.00
4	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)	13,200.00
5	PUNIMET E LËSHESAVE (TOMBINAVE) DHE KANALEVE TË HAPURA	800.00
6	PUNIMET E MBISTRUKTURËS ASFALTIT DHE BETONIT	65,829.00

	TOTALI ME TVSH	86,726.00
--	-----------------------	------------------

REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM I ASFALTIMIT RRUGËVE NË Jashanice Pograxhe Resnik Jelloc

1	ASFALTIMI I RRUGËS	86,726.00
	TOTALI ME TVSH	86,726.00

2. PARAMASA PËR NDËRTIMIN E KANALIZIMIT NË FSHATIN Jashanice Jelloc Resnik Pograxhë

2	PUNET PREGADITORE				
NR.	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Gjithësej (€)
1.1	Shënimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet kanalizimi sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet.Llog në m'	m'	400.00	0.20	80.00
1.2	Punët parapërgatitore, shënimi gjeodezik si dhe verifikimi i trasesë së vjetër të kanalizimit ,në matjet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike, po ashtu të maten diëznivelet dhe të mundesohet kyqja e kolektorve të vjetër në kolektorin e ri , kyqja dhe shkarkimi i gropave septike elzistuese në rrjetin e ri të kanalizimit sipas projektit dhe detaleve teknike. Llog në m1 Matjet gjeodezike në fund të projektit përfshihen të gjitha punët e kryera te sjellen hartat me kushtet e përgjithshme dhe teknike me gjeodet të lincenuar.	m'	400.00	0.20	80.00
1.3	Pastrimi i terenit nga mbeturinat,e ngurta ndërtimore ,shkurret drunjët e pyllëzuar - në zonat ku do të kalojë traseja e kanalizimit . Pastrimi i tyre bëhet normal me rrjedhën e kanalizimit me grësi 3m për ti mundësuar futjen normale të makinerisë për gërmim si dhe largimin e tyre në deponi, Deponin e cakton Investitori.. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rethojave dhe kthimin në gjendje të më parshme pas përfundimit të punimve. Llog në m²	m'	400.00	0.20	80.00
1.6	Demolimi i rrjetit ekzistues te vjeter, pastrimi i terenit dhe krijimi i kushteve ndertimore per instalimin e rrjetit te ri. Llog ne m' me te gjitha shpenzimet	m'	10.00	0.20	2.00
GJITHËSEJ PUNIMET PREGADITORE					242.00

2	PUNËT E DHEUT				
2.1	Gërmimi dhe Hapja e kanalit për tokë fushore të kategorisë III-IV në thellësi prej 0.8 m' deri në thellësinë 5.30 m' për kanalizimi. Fekal dhe gjerësi të nevojshme për punë duke percjellë të gjitha pikat gjeodezike sipas profilit gjatësorë dhe dispozitës së projektit. Pas hapjes së kanalit të ngjeshet me vibratör pjesa e trases së kanalizimit. Vërejtje: Sigurimin nga shembja duhet ta bëjë punëkryersi, sipas detaleve teknike të përfshira në projekt. Sqarim : Ky lloj e kategorisë së dheut përfshinë të gjithë zone ku kalon traseja e kanalizimit duke filluar prej Stacionazhes 0.00 deri në përfundim të kanalizimit në stacionazhen e fundit.				
	Punët me makineri (90%)	m3	1,000.00	0.50	500.00
	Punët me dorë (10%)	m3	110.00	0.50	55.00
2.2	Gërmimi dhe hapja e dheut për tokë fushore të kategorisë III-VII duke llogaritur edhe deponi e mbushur me materialle inerte për hapjen e pusëtave të kanalizimit në bazë të detaleve, skicave të përfshirë në projekt.				
	Punët me makineri (90%)	m3	45.00	0.30	13.50
	Punët me dorë (10%)	m3	5.00	0.30	1.50
2.3	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së pusëtës nga materiali guror para se të bëhet kineta (Bazamenti pusëtës), Fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=250 kg/cm². Materiali i përdorur duhet të jetë i paisur me ateste paraprake dhe atë sipas normave dhe standardeve. Vërejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.	m3	3.50	2.00	7.00
2.4	Furnizimi dhe shtrirja e Rërës 0-1mm, trashësi 10cm për shtratin nën gyp me planifikim ±3cm, dhe 15 cm mbi gyp për mbulimin dhe mbrojtjen e gypit, sipas vërejtjeve dhe përkrahjeve teknike paraprake të specifikuar për punimet tokësore. Gjatë vendosje së rërës të aplikohet glanumetria të përcaktuar në bazë të rregullave dhe standardeve për aplikimin të materialeve ndërtimore në vepër. Llog m3	m3	70.00	2.00	140.00
2.5	Largimin e ujërave nëntoksorë të cilët shfaqen gjatë gërmimit të kanalit, të cilët pengojë ecimin e punës në instalimin e rrjetit të kanalizimit. Llog. me ore/pune me aprovimin e organit mbikqyre	ore/pune	5.00	5.00	25.00

2.6	Vendosja e trakës mbrojtëse sinjalizuese me gjerësi 3 cm përgjatë gjitha trasësë së rrjetit të kanalizimit , për ta identifikuar zonën se ku ndodhet gypat pas mbulimit të kanalit.	m'	400.00	0.10	40.00
2.7	Mbushja dhe mbulimi e kanalit pas vendosjes së gypit me sasi të dheut të përzgjedhur pa gurë me trashësi sipas skicave dhe detaleve të percaktuara në projekt për secilen pusete /stacionazh, pastaj vendoset pjesa tjetër e dheut deri në mbushje përfundimtare të terenit dhe kthimi në gjendje të mëparshme , dhe i tepër largohet në deponin më të afërt deri në 15 km largësi.	m3	780.00	0.10	78.00
GJITHËSEJ PUNIMET E DHEUT					860.00
3 PUNËT LATUESE (VENDOSJA E GYPAVE TË KANALIZIMIT)					
3.1	Furnizimi dhe punimi i bazamentit të pusetave prej betoni C- 25/30 të armuar me klasë të armatures S-400/500 ,si dhe punimi i kinetës së pusetes duke i dhënë ramjen e duhur në drejtim të rrjedhës së kolektorit sipas detalit teknik të prezentuar në projekt. Furnizimi dhe montimi i tubave të betonit Ø800 mm nga betoni i parafabrikuar i papërshkueshëm nga uji. Kompania ekzekutuese është e obliguar që ta bëjë montimin dhe lidhjen në mes gypave në mënyrë profesionale duke filluar prej montimit të gypit mbi kinetë dhe vazhdon me lartësi të ngritje deri të kuota gjeodezike të percaktuar në profilin gjatësorë të projektit të përfshirë edhe konuset pa kapakë. Lidhja e gypave në mes veti bëhet me llaq çimentoje me raport të reçetës 1:3.	copë	6.00	5.00	30.00
3.2	Furnizimi dhe vendosja e kapakeve të pusetave nga materiali i beton armës DN 800 mm izoluar për mos depertimin e ujerave atmosferike në puseten e kanalizimit fekal. Sipas detali të prezentuar në projekt	copë	6.00	7.00	42.00
3.3	Vendosja e unazave për nivelizimin e depërtimit të gypit i cili futet në pusetë betoni me dimensione sipas projektit , dhe mbështetë në kinet për shpërkimim e kontrolluara të ujit kanalizimit në pusetë, unaza në kinet dhe në depërtimin e pusetës duhet përfordhet me fugal llaç me raport 1:1 sipasi skicës së projektit. Vërejtje : Gjatë ekzekutimit të punimeve duhet patur kujdes që të ndërmmirren të gjitha masa izoluese që parandalohet rrjedhja para se të futet në puset uji fekal dhe mos shkaktohen ndotje ambientale.				
	Unaza DN 250 mm	copë	400.00	0.20	80.00

3.4	Furnizimi dhe vendosja e gypave nga Materiali HDPE kualiteti PSN 8, përgjatë gjithë gjatësisë së trasës së kanalizimit, duke përcjellur nivelimin dhe pjerrtësin e ramjes në bazë projektit, me të gjitha elementet përcjellëse duke vendosur unaza nga goma ku lidhen gypat për të parandaluar lëvizjen e gypave dhe duke pamundësuar hyrjen e gjesendeve të ngurta të cilët bllokojnë gypin. Gjate ekzekutimit te projektit te rrespektohen detalet teknike te perfshire ne prcrjen terthore dhe gjatesore po ashtu te rrespektohen kuotat gjeodezike te perfshira projekt. Vërejtje : Punëkryesi pasi të filloj vendosjen dhe instalimin e gypave duhet ti dorzoj atestet e materialeve konform specifikacionit teknik të projektit				
	GYP HDPE PSN 8 DN 250 mm	m'	400.00	15.00	6,000.00
					6,152.00
4	PUNËT TË TJERA				
REKAPITULIMI - NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË FSHATIN Jashanice Jelloc Resnik Pograxhë					
1	GJITHËSEJ PUNIMET PREGADITORE				242.00
2	GJITHËSEJ PUNIMET E DHEUT				860.00
3	GJITHËSEJ PUNIMET LATUESE				6,152.00
TOTALI ME TVSH					7,254.00

1	Totali I Rrugëve :	86,726.00
2	Totali I Kanalizimit :	7,254.00
Totali :		93,980.00



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 634-25-6000-5-2-1/C903

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makinoria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguheshin ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6

Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do t'i jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, t'i kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7

Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejet e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktivitetëve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të sigurojë një sigurim nga dita e fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmtet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë qmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

